



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:021031

Datë: 19.02.2025

Numri i dokumentit: 06870327

C.nr.54/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.A.nga fshati K.-Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, me adresë rr. "Fehmi Agani", Hy-25/4, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, me objekt kontesti kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, vlera e kontestit 1,328.40 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses M.A.nga fshati K.-Komuna e Malishevës dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, për periudhën kohore nga data 01.02.2021 e deri me datë 06.02.2023 apo për 24 muaj, (për çdo muaj shumëmbetur prej 55.35 Euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit-licencimit, të shkallës prej 27% të pagës bazë-421.00 Euro), t'ia paguaj paditëses së lartcekur shumëmbetur e përgjithshme prej 1,328.40 Euro (njëmijë e treqind e njëzetë e tetë Euro e katërdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 07.12.2023 (datë e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumëmbetur e përgjithshme prej 124.00 Euro (njëqind e njëzet e katër Euro), në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja M.A.nga fshati K.-Komuna e Malishevës përmes së autorizuarit të saj Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë me datën 07.12.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, për

kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, duke theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse klasore në shkollën SHFMU “K.R.”, në fshatin K.-Komuna e Malishevës. Ka kërkuar që në emër të kualifikimit, paditëses t’i paguhet diferenca në pagë nga data 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023, në shumën prej 1,328.40 Euro, duke kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit së saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 24.12.2024, ku ka theksuar se në këtë rast lidhur me pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive, për faktin se në bazë të kontratës së mësimdhënësve kualifikimi u paguhet çdo mësimdhënësi që është paraqitur në kontratën e punës gradimi mbi pagën bazë. Tutje ka theksuar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021, në veçanti në nenin 7 pika 1.3 të kësaj kontrate përcaktohet se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi dhe se të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënësi me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% të pagës bazë, e ndër tjera ka shtuar se kjo kërkesëpadi është e paarsyeshme edhe për nga lartësia e shumës që është kërkuar. Sipas vendimit të qeverisë paditësit i marrin pagesat çdo muaj në bazë të kualifikimit-licencimit, por që sipas të paditurës paditësi në këtë rast nuk e ka ofruar licencën e punës si mësimdhënësi nga MASHT-i. Poashtu sipas pretendimeve të të autorizuarit të së paditurës dispozitat e nenit të sipërcituar nuk kanë karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit dhe se nga kjo dispozitë shihet qartë se qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar dhe asesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate, ku në nenin 35, janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu që nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare të së paditurës: kompensimi për orët shtesë, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë të pranuar nga enti i statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar në nenin 7 të kësaj kontrate për shkak të mungesës dhe mosplanifikimit të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se: *“Pagat e punëtorëve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj kontrate, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim”*, andaj me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara. Ka theksuar poashtu se lidhur me këtë padi të parashtruar nga ana e paditëses, e njëjta ka arritur parashkrimin në bazë të nenit 352 dhe 353 par.1 të LMD-së. Poashtu ka shtuar se padia e paditëses është paraqitur pas afatit ligjor në vitin 2024, kjo pasi kontrata kolektive e vitit 2021 është shkëputur nga MASHT-i me datë

22.11.2022. I ka propozuar gjykatës që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar sepse nuk ekziston asnjë bazë ligjore që ekziston si detyrim për të paditurën në bazë të kontratë kolektive të vitit 2021.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kontrata e punës nr.11/1014 e datës 24.09.2018, diplomën e kualifikimit universitar nr.734, licencën e mësimdhënësit me nr.1030004 dhe listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit (këtu e paditura), paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SHFMU “K.R.”, në fshatin K.-Komuna e Malishevës, si mësimdhënëse klasore.

Nga diploma e kualifikimit universitar, vërtetohet fakti se: Paditësja M.A.studimet e nivelit Master i ka mbaruar me datë 6 tetor 2020 (diploma nr.734) në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prishtinë dhe ka marrë titullin Master i Pedagogjisë së Përgjithshme. Po ashtu nga licenca e mësimdhënësit vërtetohet fakti se paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 1030004. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 421.00 Euro dhe në emër të kualifikimit me fakultet për çdo muaj paditëses i është paguar shuma nga 58.32 Euro dhe kjo listë e pagave vërtetohet edhe me datën e lindjes që përputhet me diplomën dhe licencën e lartcekur, si dhe me numrin personal. Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura gjykata ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që: *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit-licencimit, në të cilën përcaktohet se:

“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”. Pasi nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare me titull Master i Pedagogjisë së Përgjithshme dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

Gjykata vlerësoj se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Bachelor, pasi është paguar në shumën prej 58.32 Euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagave), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 Euro, (27% e pagës bazë 421.00 Euro), me ç’rast i ka mbetur borxh paditëses për çdo muaj në shumën prej 55.35 Euro dhe atë për 24 muaj ($421.00 \text{ Euro} * 27\% = 113.67 \text{ Euro} - 58.32 \text{ Euro} = 55.35 \text{ Euro} * 24 \text{ muaj} = 1,328.40 \text{ Euro}$), konkretisht për periudhën kohore nga data 01.02.2021 e deri me datë 06.02.2023, përkatësisht 24 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca për çdo muaj nga 55.35 Euro.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, gjykata vendosi duke pasur parasysh kërkesën e paditëses ku ka kërkuar që në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit-licencimit t’i njihet shtesa në vlerë prej 55.35 Euro për periudhën prej datës 01.02.2021 e gjer më 06.02.2023 ($421.00 \text{ Euro} * 27\% = 113.67 \text{ Euro} - 58.32 \text{ Euro} = 55.35 \text{ Euro} * 24 \text{ muaj} = 1,328.40 \text{ Euro}$), kërkesën e tillë gjykata e aprovoi në tërësi, por vlen të theksohet se gjykata në rastin konkret nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja ka diplomë universitare me titull Master i Pedagogjisë së Përgjithshme, ndërsa sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008, në pikën 4. të këtij vendimi parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit-licencimit, në të cilën përcaktohet se: “.....4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”, paditëses në rastin konkret do duhej t’i llogaritej kualifikimi në shkallë prej 35% ($421.00 \text{ Euro} * 35\% = 147.35 \text{ Euro} - 58.32 \text{ Euro} = 89.03 \text{ Euro} * 24 \text{ muaj} = 2,136.72 \text{ Euro}$), ashtu që për periudhën kohore nga data 01.02.2021 e deri me datë 06.02.2023, përkatësisht 24 muaj, për këtë periudhë paditëses i ka takuar diferenca për çdo muaj nga 89.03 Euro apo për 24 muaj shuma e përgjithshme prej 2,136.72 Euro, mirëpo gjykata në rastin konkret nuk ka pasur të drejtë të vendos “diçka më shumë” se që ka kërkuar pala me padi, kjo duke u bazuar në nenin 2 të LPK-së ku shprehimisht theksohet që: “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, andaj gjykata vendosi sikurse në pikën I. të dispozitivit të

këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, ashtu sikurse ka kërkuar paditësja në kërkesëpadi.

Meqenëse nga parashtrësja e padisë u konstatua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, fakt ky që nuk u kontestua nga ana e të paditurës, dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit për kualifikim sepse sipas të njëjtës mësimdhënësit paguhen për çdo muaj për kualifikim, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, andaj gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës në bazë të kualifikimit dhe atë për periudhën nga data 01.02.2021 e deri me datë 06.02.2023, përkatësisht 24 muaj.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumat përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 07.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj paditëses.

Gjykata e ka vlerësuar pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore në kontratën kolektive pasi ky kompensim nuk është përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiës rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim është tërësisht i pabazuar, ngase kërkesëpadinë e paditësja e bazon për periudhën e kërkuar prej datës 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023, pasi konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 07.12.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësja e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë.

Më konkretisht, me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 07.12.2023, në kuptim të nenit 369 të LMD-së ku theksohet se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me*

çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”, gjykata vlerëson se në këtë rast është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.02.2021 e deri më 06.02.2023 dhe padia e njëjtë është paraqitur brenda afatit ligjor. Po ashtu, Gjkata pagën bazë të paditëses e ka llogaritur duke u bazuar në listën e pagave dhe kontratës së punës. Andaj, mbi këtë bazë gjykata e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjkata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 104.00 Euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 Euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Prandaj, gjykata nga arsyet e cekura si më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil

C.nr.54/2024, me datë 19.02.2025

G j y q t a r j a

Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.